

Myftiu Tërnavë: T'u ndalohe hyrja në Kosovë ekstremistëve islamë

Myftiu i Kosovës, Naim Tërnavë në një intervistë për RTK-në, u ka bërë thirrje institucioneve kompetente të Kosovës të ndalojnë hyrjen në vend të shtetasve të huaj, të cilët me veprimet e tyre po prishin imazhin e fesë islame në Kosovë dhe po dëmtojnë tolerancën fetare të kultivuar me shekuj ndër shqiptarë.

Me pamjen e tyre, ata dëshmojnë se nuk përkohet aspak edhe me realitetin që ekziston në Kosovë, ka shtuar myftiu Tërnavë.

Bashkësia Islame dëshiron që xhaminë në truallin e ndarë afër ndërtesës së postës, ta ndërtojë nëpërmjet një konkursi ndërkombëtar.

Ata duan që ky tempull fetar të

ketë imazh të veçantë, sikurse katedralja, me të cilën do të identifikohet Prishtina. Për këtë, Myftiu i Kosovës shpreson që Komuna t'u japë hapësirë edhe ndonjë ari më shumë.

Parkingu i veturave afër PTK-së, nuk po ia mbush syrin myftiut të Kosovës. Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Naim Tërnavë do të dëshironte që Komuna, vendin ku e ka caktuar të ndërtohet xhamia më e madhe në Kosovë, të rritet edhe pak.

Kjo hapësirë, sipas myftiut, është e mirë, por nuk është e mjaftueshme për xhaminë që mendohet se do të ndërtohet.

"Shpresoj se do të gjejmë mirëkuptim nga Komuna e Prishtinës, që vendi ku na është ndarë për xhami, të rritet edhe pak", ka deklaruar Naim Tërnavë, në një intervistë për RTK.

Ky zgjerim, sipas Tërnavës, i duhet këtij projekti, pasi që Bashkësia Islame po mendon ta ndërtojë një xhami të madhe, sikurse katedralja.

Ai madje dëshiron që xhamia e re të jetë edhe si pikë referimi për Prishtinën.

"Plani është që xhamia afër PTK-së të jetë reprezentative, që të krijojë një imazh të veçantë sikurse katedralja. Pra, të jetë si pikë referimi", ka thënë Tërnavë.

PËRGJIGJE NDAJ DEKLARATAVE TË LËSHUARA NGA BIK-U, SABRI EF. BAJGORA DHE NAIM EF. TËRNAVA

Diskriminimi ndaj klerikëve dhe profesorëve të moderuar të Islamit në Kosovë duhet të ndalojë

Përgjegjësinë për të mbrojtur Islamit në Kosovë nga agjitorët e huaj islamistë e ka BIK-u



Nga Stephen Sylejman Schwartz

Më 19 mars 2012, botova një artikull në një nga gazetaret më të mëdha politike amerikane, "The Weekly Standard", me titullin (në anglisht) "Kosovo Continues Fight Against Wahhabi Infiltration" ["Kosova vazhdon luftën kundër depërtimit të Vahabistëve"]. Artikulli u shkrua gjatë vizitës sime më të fundit në Kosovë. Ai kishte të bënte kryesisht me shkarkimin e Musli ef. Verbanit nga detyra e imamit të Xhamisë "Gazi Sinan Pasha" në Kaçanik si dhe me sfidën që imam Verbani i kishte bërë Sabri ef. Bajgorës.

Unë jam gazetar dhe autor librash. Jam drejtori ekzekutiv i Qendrës për Pluralizëm Islamik (Center for Islamic Pluralism - CIP). CIP është një rrjet ndërkombëtar studjuesish, intelektualësh, gazetarësh, klerikësh dhe aktivistësh myslimanë, të moderuar dhe tradicionalë në 25 vende të ndryshme të botës. Hapësirat kryesore të veprimit të tij janë SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Ballkani, Izraeli, Iraku, Arabia Saudite dhe India. Presidenti i CIP-it është Dr. Kemal Silay, doctor shkencash dhe profesor of Kulturës Otomane dhe asaj modern turke në Indiana University, në SHBA. Artikulli me titull "Kosova vazhdon luftën kundër depërtimit të Vahabistëve" ishte një reportazh i zakonshëm për media dhe jo ndonjë raport apo document zyrtar nga CIP.

Pas botimit të artikullit tim, u kritikova në një tekst zyrtar të udhëheqjes së BIK-ut dhe në komentet e bëra nga Sabri ef. Bajgora për median e Kosovës. Në një deklaratë me titull: "Raporti i Stefan Shvarcit - një pamflet i mbushur me shpifje", të datës

29 mars 2012, BIK shprehet se në punën time paskam ditur të jem "i njëanshëm, kontradiktor dhe tendencioz". Mirëpo, vetë deklarata e BIK-ut pranon se, "Çështje e drejta, akuza e shpifje si këto të z. Shvarcit... janë bërë edhe nga ca individë brenda Bashkësisë Islame në Kosovë." Deklarata e BIK-ut përfundon duke m'u referuar si "miku ynë z. Stefan Shvarci".

Në një intervistë me median kosovare, në të njëjtën ditë (29 mars), Sabri ef. Bajgora përsëriti këto akuzat kundër meje dhe madje kërcënoi me padi ligjore ndaj kritikuesve publikë të udhëheqjes së BIK-ut. Ai e përshkroi imam Idriz ef. Bilallin si "bashkëpunëtorin" tim. Nuk e kam pasur kurrë nderin që të takohem me imam Idriz ef. Bilallin, por e admiroj dhe do të doja ta ndihmoja, atë dhe veprimtarinë e tij, me çdo mjet brenda mundësive të mia.

Më herët, më 26 mars, Naim ef. Tërnavë, kleriku kryesor Islamik në Kosovë, u intervistua nga Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) dhe tha, siç shënohet në Kohën Ditore: "institucioneve kompetente të Kosovës të ndalojnë hyrjen në vend të shtetasve të huaj, të cilët me veprimet e tyre po prishin imazhin e fesë islame në Kosovë dhe po dëmtojnë tolerancën fetare të kultivuar me shekuj ndër shqiptarë." Megjithatë, shumica e komenteve të 26 marsit të Naim ef. Tërnavës përqendroheshin te kërkesat për një xhami të përmasave të mëdha që si ato të Katedrales Katolike në Prishtinë. Në vend që të hidhte poshtë ekstremizmin, Naim ef. Tërnavë dëshmoi në deklaratën e tij se synon vetëm që të heqë nga vetja dhe nga kolegët e tij akuzën për inkurajim të radikalizmit nëpërmjet një denoncimi sa për sy e faqe, duke vazhduar ndërkohë një polemikë të panevojshme dhe armiqësore kundër katolikëve.

Deklarata e BIK-ut është saktë kur më përshkruan mua si një "mik"

të Bashkësisë. Megjithatë, unë e deklaror hapur këtu se nuk jam dakord me Naim ef. Tërnavën në dy pika. Së pari, përgjegjësinë për të mbrojtur Islamit në Kosovë nga agjitorët e huaj islamistë nuk e kanë institucionet shtetërore që ruajnë kufijtë e Kosovës, por BIK-u, i cili ruan kufijtë e padukshëm ndërmjet myslimanëve dhe jomyslimanëve në republikë. Nëqoftëse BIK e bën të qartë se vëllimtarët dhe agjitorët e tjerë ekstremistë nuk kanë vend në Kosovë, radikalët nuk do të shkuroheshin nga ardhja në Kosovë. Naim ef. Tërnavë dhe kolegët e tij nuk mund t'ia hedhin përgjegjësinë e shëndetit moral të Islamit në republikë, autoritetëve kosovare, aq më tepër që Kosova është një shtet laik.

Së dyti, si mysliman dhe si mik i vjetër i katolikëve shqiptarë, unë besoj se debate mbi Katedralen e re në Prishtinë dhe deklaratat e pakënaqësive nga myslimanët nuk bëjnë gjë tjetër përveçse atë kundër së cilës pretendon se po lufton Naim ef. Tërnavë: "dëmtojnë tolerancën fetare të kultivuar me shekuj ndër shqiptarë." BIK, në deklaratën e 29 marsit pohoi disa herë bukur përkushtimin e vet ndaj jurisprudencës së Hanafit dhe bashkëpunimit fetar ndërmjet shqiptarëve.

Do të doja t'i besoja këto fjalë. Mirëpo, sa kohë që vazhdon diskriminimi ndaj klerikëve dhe profesorëve të moderuar të Islamit në Kosovë dhe derisa BIK të veprojë për të ndaluar fushatën aktuale të insinuatave kundër katolikëve - madje edhe më tej - unë do të vazhdoj veprimtarinë time profesionale dhe do të përmbush detyrimet e mia shpirtërore duke raportuar mbi problemet brenda BIK-ut.

Stephen Sylejman Schwartz -
Washington, DC, USA
Center for Islamic Pluralism -
www.islamicpluralism.org
3 qershor 2012

Bajgora mohon lidhjet e BIK-ut me vahabi

Në një raport të përpiluar nga eksperti, Stephen Sulejman Schwartz, i cili është drejtor ekzekutiv i "Qendrës për Pluralizëm Islamik" me seli në Uashington të SHBA-ve, thuhet se funksionarët fetarë në Kosovë janë vahabi, të korruptuar dhe të pandershëm. Por, ky raport nga drejtuesit e Bashkësisë Islame të Kosovës, vlerësohet shpifës, me tendencë që të dëmtohet imazhi i BIK-ut në Kosovë.

Krerët e Bashkësisë Islame të Kosovës, gjithashtu kanë paralajmëruar edhe aktipadi ndaj tyre që po bëjnë shpifje, të cilët në njëfarë mënyre po mundohet të njollosojnë punën e ndershme të BIK-ut.

Në raportin e Schwartzit, mes tjerash thuhet se Sabri Bajgora shihet si një shërbëtor i Naim Tërnavës, i cili është koka vahabiste në Bashkësinë Islame të Kosovës që nga viti 2003.

Por, kryeimami i Kosovës, Sabri Bajgora, i hedh poshtë të gjitha këto konstatime, duke thënë se emri i Stefan Schwartz nuk është i panjohur për BIK-un, ngase ky person, sipas tij edhe në të kaluarën ka shkruar shkrime të tilla fyese dhe denigruese për komitetin mysliman të Kosovës.

Për më tepër, Bajgora ka thënë se Schwartz është një person shumë kontrovers, një person i cili vazhdimisht merret me shpifje tendencioze ndaj krerëve të BIK-ut.

"Sigurisht se dikujt i pengon aktiviteti i BIK-ut, i pengojnë reformat që vazhdojnë çdo ditë të bëhen në këtë institucion. Besoj se nuk ja vlen te merremi me raporte të tilla, sepse hulumtimi që e ka bërë Stephen Schwartz, kryesisht bazohet në shpifje tendencioze, që fatkeqsisht janë të ushqyera nga disa njerëz të pandërgjegjshëm që veprojnë nën ombrellën e Bashkësisë Islame të Kosovës", ka thënë Bajgora.

Ai ka hedhur poshtë të gjitha ato që thuhet në raportin e Schwartzit, duke cituar edhe një deklaratë të më hershme të myftiut Naim Tërnavë, i cili kishte thënë se nuk ka vend për panik, se në vend ekziston ndonjë grup radikal vahabist, apo grupe me tendencë ekstremiste.

Kryeimami i Kosovës, është pyetur nga Kosovapress, edhe për pjesën e raportit të Schwartzit ku thuhet se në krye të pozitave udhëheqëse të BIK-ut, po vihen njerëz të pashkolluar dhe vahabi, ndërsa po largohen ata që janë të arsimuar dhe të kualifikuar, duke ju referuar zgjedhjeve të fundit në Komunën e Kaçanikut.

"Kjo është tërësisht e pavërtetë dhe nuk qëndron fare, sepse kryetari i sapo emëruar në Kaçanik është Florim Neziraj, është kuadër i fakulteti të studimeve Islame në Kosovë, është një kuadër i shkolluar në kujdesen e BIK-ut, sepse edhe vet qëllimi i themelimit të këtij fakulteti ka qenë pikërisht që t'u japim hapësirë studentëve tanë që të shkollohen në këtë klimë të tolerancës dhe të mos infiltrohen nga mësimet e ndryshme që mund t'i marrin anekënd botës arabe, apo islame. Andaj dikujt edhe sigurisht i pengon që në Bashkësinë Islame në Kosovë kanë filluar reformat të mëdha, ku në shprehje po vënë kuadro të reja që kanë dal pikër-



Sabri Bajgora

isht nga gjiri i këtij popullit", ka thënë ai.

Por, jo vetëm në raport e Stefan Schwartz, thuhet që BIK-u në pozita udhëheqëse po vendos vahabist. Mendim të njëjtë ka edhe imami i xhamisë "Metë Podujeva" në Podujevë, Idriz Bilalli, njëherit edhe kryetar i Sindikatës së Punëtorëve të Bashkësisë Islame të Kosovës, i cili kohë më parë është shkarkuar nga detyra e udhëheqësit të degës së BIK-ut në Podujevë. Ai ka thënë nëpërmjet telefonit për Kosovapress se raporti i Stefan Schwartz, bazohet në tolerimet që kryetari i Bashkësisë Islame në Kosovë po u bënë radikalëve islamik, duke i vënë disa pre tyre në pozita drejtuese.

"Ai ka toleruar këtë rrymë vahabiste në Kosovë që të depërtojë, dhe sigurisht se në bazë të kësaj edhe ka raporte të tilla, ka nëpunës në Bashkësinë Islame që kanë marrë pozita gjatë mandatit të këtij zotërisë që është në krye të Bashkësisë Islame (Naim Tërnavë) dhe me siguri në këtë parim ka filluar edhe ky raport. I ka toleruar të depërtojnë nëpër pozita të Bashkësisë Islame, profesorë, imam të xhamisë dhe pozita të tjera dhe në bazë të kësaj mundet me kanë një koalicion i heshtur, siç unë e kam quajtur me këta radikalët islamik këtu në Kosovë", ka thënë Bilalli nëpërmjet telefonit.

Por, për Bajgorën, njerëz siç është, Idriz Bilalli, cilësohen si bashkëpunëtor të Schwartzit. Bajgora nuk është ndalur me kaq, ai ka paralajmëruar se do të ngre aktipadi ndaj shpifësve dhe bashkëpunëtorëve të tij, ngase po adresojnë akuza të pabaza ndaj drejtuesve të Bashkësisë Islame në Kosovë.

"Në pamundësi për të ardhur në shprehje dëshirat e tyre karrieriste, atëherë ata dalin në opinion dhe ofrojnë shpifje të ndryshme, prandaj ne jemi seriozisht duke menduar që të ngrejme edhe aktipadi ndoshta edhe private, edhe në kontestet civile rreth këtyre shpifjeve, të cilat po e dëmtojnë imazhin e besimtarëve dhe imazhin e Bashkësisë Islame të Kosovës në përgjithësi", ka thënë kryeimami i Kosovës.

Për më tepër, ai ka thënë se në Kosovë nuk ka pasur dhe nuk do të ketë vend për vahabistë dhe radikalizëm islamik, ngase sipas tij, këtë ia mundëson edhe pozita gjeografike në të cilën ndodhet Kosova.

(Kosovapress)